



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI SHTETËROR PËR
INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

Nr. 189 Prot.
Tiranë, më 12 . 03 .2024

KORPORATA E INVESTIMEVE
SHQIPTARE

Nr. 46 Prot.
Tiranë, më 07 . 03 .2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Kjo **MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI** nënshkruhet ndërmjet:

Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), institucion publik qendror, me NIPT L31919452G dhe adresë: Rruga "Papa Gjon Pali II" Nr. 3, 1010 Tiranë, i krijuar me ligjin nr. 72/2012, datë 28.06.2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", përfaqësuar nga Znj. Vilma TOMÇO, Drejtor i Përgjithshëm,

(në vazhdim "ASIG")

dhe

Korporatës së Investimeve Shqiptare SH.A., një shoqëri aksionare e së drejtës shqiptare me kapital shtetëror, me numër unik identifikimi M01917011D, dhe me adresë: Rruga Ibrahim Rugova, pallati Sky Tower, 1001, Tiranë, përfaqësuar nga Znj. Elira KOKONA, Drejtor Ekzekutiv,

(në vazhdim "AIC")

(ASIG dhe AIC individualisht referuar si "Palë" dhe së bashku "Palët")

Neni 1 Objekti

Objekti i Marrëveshjes është rregullimi dhe institucionalizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit mes palëve, për shkëmbimin e informacionit, dokumentave apo konsultimit për nismat dhe projektet e ndryshme të zhvillimit që prekin sektorin e gjeoinformacionit.

Neni 2 Fushat e Bashkëpunimit

1. Marrëveshja zbatohet për të gjitha të dhënat, informacionet apo dokumentat që lidhen, direkt apo indirekt me fushën e informacionit gjeohapësinor sipas përcaktimeve të ligjit nr. 72/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë".

2. Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për nismat dhe projektet specifike që secila Palë ndërmerr dhe për të cilat nevojitet ekspertiza e Palës tjetër. Ato shkëmbejnë informacion, dokumenta apo ekspertizë teknike sipas procedurës së parashikuar në legjislacionin sektorial dhe në këtë Marrëveshje.
3. Palët angazhohen të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në mirëbesim dhe t'i përgjigjen njëra-tjetrës në një kohë optimale brenda afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.
4. Palët kanë rënë dakord që të shkëmbejnë informacione gjeohapësinore dhe të japin mendime e rekomandime profesionale teknike dhe financiare për këto projekte.
5. Palët janë pajtuar të vënë në dispozicion të njëra-tjetrës ekspertizën e ndërsjellë në fushat respektive.

Neni 3 Angazhimet dhe të drejtat e ASIG

1. ASIG është autoriteti përgjegjës për zbatimin e politikës kombëtare për infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor. Mes të tjerash, ASIG, siguron bashkërendimin e punës gjatë aktiviteteve dhe marrjes së nismave që lidhen me informacionin gjeohapësinor në sektorin publik dhe privat si edhe jep rekomandime teknike dhe financiare mbi realizimin e këtyre nismave.
2. ASIG bashkëpunon ngushtë me sektorin publik dhe privat me qëllim krijimin e një baze të dhënash gjeohapësinore sa më gjithëpërfshirëse.
3. ASIG si autoritet përgjegjës për fushën e gjeoinformacionit, angazhohet ti sigurojë palës tjetër të dhënat gjeohapësinore të mbledhura, përpunuara dhe të përditësuara nga autoritet publike përgjegjëse sipas kuadrit ligjor në fuqi, për nismat e ndërmarra nga pala tjetër për projektet e zhvillimit dhe menaxhimit të pronave shtetërore.
4. ASIG merr përsipër të ofrojë ekspertizë teknike të nevojshme për palën mbi nismat apo veprimet në proces zbatimi, për projektet me objekt zhvillimin dhe menaxhimin e pronave shtetërore, sipas objektit të veprimtarisë së palës.

Neni 4 Angazhimet dhe të drejtat e AIC

1. AIC është person juridik i organizuar në formën e një shoqërie aksionare sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe ligjit nr.71/2019 "Për Korporatën e Investimeve Shqiptare" me pronar të vetëm të kapitalit-aksionar shtetin, i përfaqësuar nga Ministri përgjegjës për ekonominë.
2. Një ndër funksionet ligjore të AIC është zhvillimi dhe menaxhimi i pronave dhe projekteve në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit.

3. AIC këshillon institucionet publike dhe private në hartimin, analizimin, dhe rekomandimin e projekteve dhe financon ose bashkëfinancion projekte në të cilat janë të përfshira pronat shtetërore;
4. Për përmbushjen e mandatit ligjor dhe statutor të AIC në mënyrë efikente nevojten të dhëna për infrastrukturën gjeohapësinore të pronave në të cilat do të realizohen projektet e zhvillimit dhe menaxhimit të pronave shtetërore
5. AIC merr përsipër të ofrojë të dhëna mbi pronat shtetërore, objekt i projekteve të zhvillimit, mbi të dhënat gjeohapësinore për publikimin e tyre në Gjeoportalin Kombëtar.
6. AIC merr përsipër të ftojë dhe të angazhojë ASIG në projekte inovative që i shërbejnë zhvillimit të sektorit të gjeoinformacionit.

Neni 5 **Personat e kontaktit**

1. Secila Palë cakton një person kontakti i cili monitoron zbatimin e kësaj marrëveshje. Nëse personi i kontakti së njërës Palë ndryshon, kjo Palë ka detyrë të lajmërojë Palën tjetër për ndryshimin.
2. Në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, personat e kontaktit janë:

Për ASIG: **Z. Dritan Domi**
Dritan.Domi@asig.gov.al
+355684033440

Për AIC: **Znj.Edit Uruci**
edit.uruci@aicorporation.al
+355698531161

Neni 6 **Kohëzgjatja e Marrëveshjes dhe Përfundimi i saj**

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe lidhet për një afat të pacaktuar.
2. Secila Palë mund të zgjidh Marrëveshjen në çdo kohë nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Palës tjetër.

Neni 7
Të ndryshme

1. Marrëveshja nuk krijon të drejta të zbatueshme në gjykata apo institucione të tjera ligjzbatuese si edhe nuk krijon detyrime financiare ndërmjet Palëve.
2. Marrëveshja nënshkruhet në dy kopje në gjuhën shqipe.

Datë _____

Nënshkrimi _____



Znj. Vilma TOMÇO

Drejtör i Përgjithshëm
Autoriteti Shtetëror për Informacionin
Gjeohapësinor

Datë _____

Nënshkrimi _____



Znj. Elira KOKONA

Drejtör Ekzekutiv,
Korporata e Investimeve Shqiptare
SH.A.

